

UTS TRUPE PËR ÇERTIFIKIMIN E PERSONAVE ”UNITEC-STUDIO” shpk	PROÇEDURA E EKZAMINIMIT TË ELEKTRIÇISTËVE	Botimi: 01
		Nr. Doc : PT-EL-UTS-9.3.2
		Rishikimi: 00
Kopje Nr 1 nga 3 ne shperndarje te kontrolluar		Data: 10/04/2020
Adresa: Rruga »Gjergj Fishta » Nd. 2; H.39 ; Ap 8; Nj.A.V.10-1001 Tirane		Faqe 1 of 14

Procedura e ekzaminimit të elektricistëve PT-EL-UTS-9.3.2

UTS TRUPE PËR ÇERTIFIKIMIN E PERSONAVE ”UNITEC-STUDIO” shpk	PROÇEDURA E EKZAMINIMIT TË ELEKTRICISTËVE	Botimi: 01
		Nr. Doc : PT-EL-UTS-9.3.2
		Rishikimi: 00
		Data: 10/04/2020
Kopje Nr 1 nga 3 ne shperndarje te kontrolluar		Faqe 2 of 14
Adresa: Rruga »Gjergj Fishta » Nd. 2; H.39 ; Ap 8; Nj.A.V.10-1001 Tirane		

1. QËLLIMI

Ky dokument përcakton aktivitetet, zhvillimin e saktë dhe me korrektësi të procedurave që zbatohen nga Trupa Çertifikuese UTS shpk, sipas të cilave vlerësohet nëse aplikanti për tu çertifikuar, përmbush kërkesat e kompetencës të specifikuaranë skemën e çertifikimit të personelit elektrik.

2. DOKUMENTAT REFERUES

Kjo procedurë mbështetet në:

- Standardin ISO/IEC 17024:2012 “Vlerësimi i konformitetit - Kërkesa të përgjithëshme për organizma që bëjnë certifikimin e personelit”,
- Ligjin Nr. 8734, datë 01.02.2001 “ Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, i ndryshuar
- Ligjin Nr. 13 , datë 14.02.2013 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8734, datë 01.02.2001- Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike”
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1061, datë 23. 12. 2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit”, dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara.
- Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impjantet, pajisjet dhe instalimet elektrike miratuar nga Ministria e Industrisë dhe Energjitikës, Nr.3403/1, date 30.06.2003
- Skema e certifikimit të elektricistëve, Kodi SC-EL-UTS-01.

3. APLIKIMI

Procedura e certifikimit nis me plotësimin nga kandidati për tu certifikuar një formular sipas formës FO-UTS-9.1.2, (Formulari i Aplikimit), i cili përmban por jo vetëm:

- Qëllimin e certifikimit të kërkuar duke përcaktuar paraprakisht edhe grupin e sigurimit teknik elektrik,
- Informacion të përgjithshëm si psh: emri, atësia, mbiemri, datëlindja, arsimit, profesioni, vendi i punës, vjetërsia në punë dhe adresa e banimit,
- Një deklaratë nga ana e personit që kërkon të certifikohet me anë të së cilës ai pranon se është i gatshëm të plotësojë kërkesat për certifikimin, të japë çdo informacion tjetër të nevojshëm për vlerësimin, kur kjo të jetë e nevojshme, si dhe të shlyejë paraprakisht koston e procesit të certifikimit sipas listës së tarifave, e cila është e publikuar nëëbsitin e Trupës Çertifikuese
- Detaje mbi kualifikimet profesionale të vërtetuara

Formularit të aplikimit FO-UTS-9.1.2, i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme:

UTS TRUPE PËR ÇERTIFIKIMIN E PERSONAVE ”UNITEC-STUDIO” shpk	PROÇEDURA E EKZAMINIMIT TË ELEKTRICISTËVE	Botimi: 01
		Nr. Doc : PT-EL-UTS-9.3.2
		Rishikimi: 00
		Data: 10/04/2020
Kopje Nr 1 nga 3 ne shperndarje te kontrolluar		Faqe 3 of 14
Adresa: Rruga »Gjergj Fishta » Nd. 2; H.39 ; Ap 8; Nj.A.V.10-1001 Tirane		

- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike,
- Vërtetim i aftësisë për punë¹
- Fotokopje e diplomës ose dëftesë së arsimimit (nëse ka),
- CV e aplikantit,
- 2 fotografi format pashaporte;

Dokumentacioni i paraqitur nga aplikanti do të jetë në gjuhën shqipe.

Çdo aplikim i shoqëruar nga dokumentacioni përkatës, do të paraqitet në dy kopje.

4. PERSONELI I PËRFSHIRË NË PROCESIN E ÇERTIFIKIMIT

Procesi i certifikimit të elektricistëve kalon në tre faza:

- Vlerësimi paraprak, ku udhëheqësi i procesit është: **Vlerësuesi paraprak.**
- Ekzaminimi dhe testimi, ku udhëheqësi të procesit janë: **Ekzaminuesit.**
- Çertifikimi, ku vendimmarresi mbi çertifikimin është: **Komiteti i Çertifikimit.**

5. VLERËSIMI

Vlerësimi planifikohet dhe të strukturohet nga manaxhimi i Trupës Çertifikuese UTS shpk, për të garantuar që kërkesat e skemës së çertifikimit verifikohen objektivisht dhe sistematikisht, me evidencë të dokumentuar për të konfirmuar kompetencën e kandidatit.

Me marrjen e dokumentacionit të kandidatit/kandidatëve, manaxheri i ekzaminimit për zgjedh ekzaminuesin, duke mbajtur parasysh kërkesat e sistemit të manaxhimit për ekzaminuesit që:

- a) të ketë kompetencë në fushën që ekzaminohet;
- b) të ketë të identifikuar që nuk ka konflikt interesi, për të garantuar që gjykimet të jenë të paanëshëm.

Në se ekzaminuesi ka një konflikt interesi potencial në ekzaminimin e një kandidati, ai plotëson dhe nënshkruan “Deklarimin e konfliktit të interesit me kandidatin”, me anën e të cilit garantohet që nuk cënohet konfidencialiteti dhe pavarësia.

Manaxheri i ekzaminimit, cakton qendrën e ekzaminimit dhe datën për ekzaminimn e përgjithëshëm. Njoftimi zyrtar i kandidatit bëhet nga Manaxheri i Cilësië dhe firmoset nga Drejtori i Çertifikimit.

Manaxhimi i trupës certifikuese verifikon dhe interesohen që të akomodohen nevojat e veçanta, brenda arsyes dhe kur nuk shkelet integriteti i vlerësimit.

UTS TRUPE PËR ÇERTIFIKIMIN E PERSONAVE ”UNITEC-STUDIO” shpk	PROÇEDURA E EKZAMINIMIT TË ELEKTRICISTËVE	Botimi: 01
		Nr. Doc : PT-EL-UTS-9.3.2
		Rishikimi: 00
		Data: 10/04/2020
Kopje Nr 1 nga 3 ne shperndarje te kontrolluar		Faqe 4 of 14
Adresa: Rruga »Gjergj Fishta » Nd. 2; H.39 ; Ap 8; Nj.A.V.10-1001 Tirane		

Aplikimi i çdo kandidati për certifikim shqyrtohet dhe verifikohet nga Vlerësuesi, i cili brenda 7 ditëve nga dita e paraqitjes së aplikimit, vendos nëse:

- Trupa Çertifikuese UTS shpk, ka aftësitë dhe kompetencën për të kryer certifikimin e kërkuar.
- Kandidati plotëson kushtet e përgjithshme për t’iu nënshtruar procesit të testimit dhe ekzaminimit.
- Kandidati plotëson kërkesat e veçanta “Skema e certifikimit të elektricistëve”, Kodi PT-EL-UTS-01.
- Kandidati do t’i nënshtrohet procesit të certifikimit vetëm nëse plotëson këto kushtet paraprake të percaktuara në, “Skema e certifikimit të elektricistëve”, Kodi PT-SEL-UTS-9.3.2,

Kur Vlerësuesi vendos që Trupa Çertifikuese UTS shpk, ka aftësitë dhe kompetencën e nevojshme për të kryer certifikimin e kërkuar dhe nga ana tjetër kandidati plotëson kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për t’iu nënshtruar ekzaminimit/testimit, atëherë procesi i certifikimit kalon në fazën e ekzaminimit, sipas, “Procedura e ekzaminimit të elektricistëve”, Kodi **PT-EL-UTS-9.3.2**

Nëse aplikanti, i plotëson kushtet për të kaluar në fazën e testimit/ekzaminimit, atëherë Vlerësuesi paraprak, me vendim të arsyetuar vendos kalimin në fazën tjetërdhe aplikanti rregjistrohet në rregjistrin e kandidateve.

Nëse aplikanti nuk plotëson qoftë edhe një prej kushteve të përgjithshme ose të veçanta të nevojshme për të kaluar në fazën e testimit/ekzaminimit, atëherë Vlerësuesi me vendim të arsyetuar vendos refuzimin e aplikimit.

Vendimi për pranimin ose refuzimin e aplikantit është përcaktuar sipas formës, “Vendim i vlerësuesit paraprak” dhe aplikantinjoftohet brenda 7-të, ditëve për vendimin e Trupës Çertifikuese UTS shpk. Vendimi është i ankimueshëm/apelueshëm, sipas, “Procedurës së apelimeve dhe ankesave”, Kodi PM-UTS-9.8 dhe për këtë qëllim plotësohet, “Formulari i apelimit”, Kodi FO-UTS-9.8.6, i cili është i publikuar nëwebsitesin e Trupës Çertifikuese.

Aplikantit, të cilit i është refuzuar aplikimi, mund të paraqesë një kërkesë të re për certifikim, në përputhje me kërkesat e kësaj Procedure.

6. EKZAMINIMI DHE TESTIMI

6.1 Ekzaminimi me shkrim dhe me gojë

Ekzaminimi teorik i kandidatit për tu certifikuar si personel elektrik kryhet në qendrën e ekzaminimit me shkrim dhe me gojë në qendrën e miratuar për këtë qëllim, ose në qendrat e miratuara nga Bordi i Çertifikimit

Ekzaminimet me shkrim dhe me gojë vlerësohen duke krahasuar përgjigjet e dhëna nga kandidati me përgjigjet kyç, të cilat janë aneks i kësaj Procedure. Çdo përgjigje korrekte llogaritet 1 pikë

UTS TRUPE PËR ÇERTIFIKIMIN E PERSONAVE ”UNITEC-STUDIO” shpk	PROÇEDURA E EKZAMINIMIT TË ELEKTRICISTËVE	Botimi: 01
		Nr. Doc : PT-EL-UTS-9.3.2
		Rishikimi: 00
		Data: 10/04/2020
Kopje Nr 1 nga 3 ne shperndarje te kontrolluar		Faqe 5 of 14
Adresa: Rruga »Gjergj Fishta » Nd. 2; H.39 ; Ap 8; Nj.A.V.10-1001 Tirane		

dhe nota që i vihet provimit është sa shuma e pikëve të arritura. Për llogaritjen përfundimtare, nota e secilit provim shprehet në përqindje.

Ekzaminimi përmban vetëm pyetje të zgjedhura në mënyrë të paparashikueshme nga trupa certifikuese mbi bazën e pyetjeve të njohurive të vlefshme në datën e provimit. Kandidatit i kërkohet si minimale, ti japë përgjigje numrit të pyetjeve të dhëna në pikën

Koha e lejuar kandidatëve për plotësimin e çdo provimi mbështetet në numrin dhe vështirësinë e pyetjeve. Koha mesatare e lejuar për pyetjet është jo më i gjatë se **3 (tre)**, minuta për pyetje. Koha mesatare e lejuar për përgjigjet individuale përcaktohet nga ekzaminuesi.

Gjatë provimit, kandidati i kërkohet ti japë përgjigje të paktën pyetjeve të tezës së zgjedhur, përfshirë pyetjet që përmbajnë procedura të shkruara pyetje për kode standarde dhe specifitime. Në se personi nuk arrin të fitojë një shkallë vlerësimi të paktën 70 %, lejohet një përpjekje tjetër mbas 7 ditësh dhe përpara 6 muajsh.

Rezultatet e provimit me shkrim, sipas dokumentit, “Teza e ekzaminimit teorik”, Kodi FO-EL-UTS-9.3.1,u komunikohen direkt aplikantëve. Rezultatet e provimit u jepen kandidatëve në vendin e testimit menjëherë pas provimit .

Rezultatet e provimit për kandidatët që zhvillojnë provimin me shkrim kanë vetëm statusin fiton/ngel dhe komisioni firmos në dokumentin,“Teza e ekzaminimit teorik”, Kodi FO-SEL-UTS-9.3.1 dhe në përfundim të ekzaminimit teorik, plotësohet, “Vendim i ekzaminuesve për rezultatin e ekzaminimit teorik”, KodiFO-EL-UTS-9.4.0 dhe në përfundim të ekzaminimit teorik, plotësohet procesverbali mbi rrezultatet e arritura nga kandidatët në ekzaminimin teorik, Kodi FO-SEL-UTS-9.4.4/1, i cili administrohet nga Menaxheri i Cilësiës dhe Komiteti i Certifikimit.

6.2 Ekzaminimi praktik

Ekzaminimi praktik kryhet në impiantin Vendimi mbahet në 2 (dy) kopje, një nga te cilat administrohet nga Menaxheri i Cilësisë dhe një kopje tejtër futet në dosjen e kandidatit.Rezultati i bashkëngjitet, “Formulari i aplikimit”, Kodi FO-UTS-9.1.2 dhe bashkë me dokumentacioni tjetër plotësues i dorëzohet Komitetit të Çertifikimit, i cili është autoriteti që do të marrë vendimin përfundimtar për çertifikimin e kandidatit.

ku shërben kandidati ose në ambjentet e marra me qera, nga Trupa Çertifikuese UTS shpk. Synimi i kërkesave të ekzaminimit është garantimi i krahasueshmërisë së rezultateve të secilit ekzaminim të veçantë, si në përmbajtje dhe në vështirësi, përfshirë vendimet mbetet/kalon.

Kandidatët që kanë kaluar me sukses fazën e ekzaminimit teorik, kalojnë në fazën e dytë, të ekzaminimit praktik. Ekzaminimi praktik fillon me tërheqjen e tezes nga kandidati i kualifikuar e cila përmban zbatimin e detyrave specifike të kandidatëve për personel elektrik i çertifikuar për klasën përkatëse të sigurimit elektrik.

UTS TRUPE PËR ÇERTIFIKIMIN E PERSONAVE ”UNITEC-STUDIO” shpk	PROÇEDURA E EKZAMINIMIT TË ELEKTRICISTËVE	Botimi: 01
		Nr. Doc : PT-EL-UTS-9.3.2
		Rishikimi: 00
		Data: 10/04/2020
Kopje Nr 1 nga 3 ne shperndarje te kontrolluar		Faqe 6 of 14
Adresa: Rruga »Gjergj Fishta » Nd. 2; H.39 ; Ap 8; Nj.A.V.10-1001 Tirane		

Ekzaminimi praktik vlerësohet duke krahasuar veprimet e kryera nga kandidati me me veprimet e përshkuara në tezën e provimit. Çdo përgjigje korrekte llogaritet 1 pikë dhe nota që i vihet provimit është sa shuma e pikëve të arritura. Për llogaritjen përfundimtare, rezultati i ekzaminimit shprehet në përqindje. Në se personi nuk arrin të fitojë një shkallë vlerësimi të paktën 70 % në provimin praktik, ai lejohet të bëjë edhe një përpjekje tjetër e cila është 7 ditë deri në 6 muajsh.

Rezultatet e ekzaminimit praktik për kandidatët që zhvillojnë provimin me shkrim kanë vetëm statusin fiton/ngel dhe komisioni firmos në dokumentin “Teza e ekzaminimit praktik”, Kodi FO-SEL-UTS-9.3.1/1 dhe në përfundim të ekzaminimit teorik, ekzaminuesit, plotësojnë, “Vendim i ekzaminuesve, për ekzaminimin praktik”, i cili administrohet në dosjen e kandidatit. Në përfundim të procesit të ekzaminimit, plotësohet procesverbali mbi rezultatet e arritura nga kandidatët në ekzaminimin praktik.

Vendimi mbahet në 2 (dy) kopje, një nga te cilat administrohet nga Menaxheri i Cilësisë dhe një kopje tejtër futet në dosjen e kandidatit. Rezultati bashkë me dokumentacionin tjetër plotësues, i dorëzohet Komitetit të Çertifikimit, i cili është autoriteti që do të marrë vendimin përfundimtar për çertifikimin e kandidatit.

Proces-verbale të ekzaminimit teorik/praktik, mbahen në 2 (dy) kopje, një nga te cilat administrohet nga Menaxheri i Cilësisë dhe një kopje tejtër futet në dosjen e kandidatit. Rezultati i dokumentacionit tjetër plotësues i dorëzohet Komitetit të Çertifikimit, i cili është autoriteti që do të marrë vendimin përfundimtar për çertifikimin e kandidatit.

7. ÇERTIFIKIMI

Bordi i Çertifikimit të Trupës Çertifikuese UTS shpk, do të mbajë autoritetin për të dhënë çertifikimin e kandidatit, pas përfundimit të të gjitha kërkesave për çertifikim.

Në përputhje me detyrimin e tij për dhënien e certifikimit të kandidatëve që plotësojnë të gjitha kërkesat, Bordi i Çertifikimit të Trupës Çertifikuese UTS shpk, do të kryejë detyrat e mëposhtme:

- Verifikon që kandidati ka plotësuar të gjitha kërkesat e aplikimit siç është përshkruar në formularin e aplikimit dhe në skemën e çertifikimit.
- Verifikon që kandidati ka marrë me sukses dhe ka kaluar ekzaminimin teorik dhe praktik.
- Njofton kandidatin për përfundimin me sukses të detyrave të kërkuara për çertifikim.
- I ofron kandidatit një certifikatë unike, në formatin dixhital ose fizik duke treguar si më poshtë:
 - Emrin e personit të certifikuar;
 - Numri identifikues unik;
 - Emri dhe logoja e Trupës Çertifikuese UTS shpk;
 - Referenca për skemën, standardin dhe titullin e çertifikimit;

UTS TRUPE PËR ÇERTIFIKIMIN E PERSONAVE ”UNITEC-STUDIO” shpk	PROÇEDURA E EKZAMINIMIT TË ELEKTRIÇISTËVE	Botimi: 01
		Nr. Doc : PT-EL-UTS-9.3.2
		Rishikimi: 00
		Data: 10/04/2020
Kopje Nr 1 nga 3 ne shperndarje te kontrolluar		Faqe 7 of 14
Adresa: Rruga »Gjergj Fishta » Nd. 2; H.39 ; Ap 8; Nj.A.V.10-1001 Tirane		

- Çdo kufizim ose kushtet e vlefshmërisë;
- Data e lëshimit / data e skadimit;
- Nënshkrimi i personit të autorizuar për lëshimin e certifikatës.
- vula e Trupës Çertifikuese UTS shpk,
- fotografia e personit të certifikuar
- logo e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit

8. PËRDORIMI I ÇERTIFIKATËS

Përpara lëshimit të Çertifikatës, Trupa Çertifikuese UTS shpk, nënshkruan një Marrëveshje ligjërish të detyrueshme me personin e certifikuar. Në këtë marrëveshje ndër të tjera, personi i certifikuar, merren përsipër:

- përgjegjësia për plotësimin e kërkesave të skemës së certifikimit,
- përgjegjësia për të zbatuar certifikimin vetëm brenda fushës së zbatimit për të cilën është lëshuar certifikimi,
- përgjegjësia për kryerjen e pagesave sipas listës së tarifave
- përgjegjësia për përdorimin e certifikatës dhe dëshmisë së aftësisë në mënyrë që mos të shkaktojë Trupa Çertifikuese UTS shpk cenimin e reputacionit,
- përgjegjësinë për ta njoftuar Organizmin e Certifikimit për cdo ndryshim lidhur me statusin e certifikimit, aftësisë për punë etj.

9. RIÇERTIFIKIMI

Bordi i Certifikimit njeh rëndësinë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe të edukimit për të gjithë personat e certifikuar. Kërkesa për riçertifikim, është hartuar për të siguruar që personat e certifikuar, të mbajnë njohuritë e tyre, në lidhje me zhvillim teknologjik dhe praktikat më të mira, të qëndrojnë të informuar për zhvillimet praktike dhe të zgjerojnë perspektivën e tyre të profesionit dhe të përforcojnë njohuritë e fituara.

Për shkak të ritmit në të cilin ndryshimet e informacionit në industri, personat e certifikuar, duhet të rinovojnë certifikimin e personelit çdo katër vjet.

Trupa Çertifikuese UTS, duhet të sigurojë gjatë procesit të reçertifikimit se ai konfirmon kompetencën e vazhdueshme të personit të certifikuar dhe përmbushjen e vazhdueshme të kërkesave të skemës aktuale nga personi i certifikuar.

Periodha e riçertifikimit bazohet në kërkesat e skemës. Arsyetimi për periudhën e riçertifikimit do të marrë parasysh, kur është e nevojshme, sa vijon:

- a) Kërkesat rregullative;
- b) Ndryshimet në dokumentet normative;
- c) Ndryshimet në kërkesat e skemës përkatëse;

UTS TRUPE PËR ÇERTIFIKIMIN E PERSONAVE ”UNITEC-STUDIO” shpk	PROÇEDURA E EKZAMINIMIT TË ELEKTRIÇISTËVE	Botimi: 01
		Nr. Doc : PT-EL-UTS-9.3.2
		Rishikimi: 00
		Data: 10/04/2020
Kopje Nr 1 nga 3 ne shperndarje te kontrolluar		Faqe 8 of 14
Adresa: Rruga »Gjergj Fishta » Nd. 2; H.39 ; Ap 8; Nj.A.V.10-1001 Tirane		

- d) Natyrën dhe pjekurinë e industrisë ose fushës në të cilën punon personi i certifikuar;
- e) Rreziqet që rezultojnë nga një person i paaftë;
- f) Ndryshimet e vazhdueshme në teknologji dhe kërkesat për personat e certifikuar;
- g) Kërkesat e palëve të interesuara;
- h) Frekuencën dhe përmbajtjen e aktiviteteve të mbikëqyrjes, nëse kërkohet nga skema.

Veprimtaritëe përzgjedhura për riçerifikim.

Aktivitetet e përzgjedhura të riçerifikimit, duhet të jenë adekuate për të siguruar që ka vlerësim të paanshëm, për të konfirmuar kompetencën e vazhdueshme të personit të certifikuar.

Në përputhje me skemën e certifikimit të personit, riçerifikimi nga Trupa Çertifikuese UTS, duhet të shqyrtojë të paktën sa më poshtë:

- a) vlerësimin në vend;
- b) Zhvillimi profesional;
- c) Intervistat e strukturuar;
- d) Konfirmimi i proceseve të kënaqshme të punës dhe të përvojës së punës;
- e) Ekzaminimi;
- f) Kontrollon aftësinë fizike në lidhje me kompetencën në fjalë.

Kodi i sjelljes së personave të certifikuar.

Kur punojnë për një firmë të certifikuar, kryejnë punë në përputhje me Standardet Procedurale të Trupës Çertifikuese UTS.

Kryeni punën në përputhje me rregulloret dhe politikat e Trupës Çertifikuese UTS.

Përgatitja e raporteve të detajuara, të cilat janë të sakta dhe të besueshme në përputhje me standardet e përshtatshme të procedurës së Trupës Çertifikuese UTS.

Raportoni të gjitha mungesat e pajisjeve dhe sistemeve, të cilat i pengojnë ata të përfundojnë punën e tyre dhe të përgatisin një raport përfundimtar, në mënyrë specifike dhe shprehimisht duke vënë në dukje në çdo raport paraprak, se është paraprak dhe jo përfundimtar dhe pa nënshkrimin e ndonjë raporti të tillë.

Raportoni dhe zgjidhni problemet nëse hasen, dhe kur ekziston një problem, njoftoni personelin e duhur të projektit duke siguruar të dhëna për shkakun e problemit dhe rekomandoni zgjidhje të mundshme.

Kryen shërbimet e tyre në mënyrë profesionale dhe me respekt për pronën dhe personelin e klientit.

UTS TRUPE PËR ÇERTIFIKIMIN E PERSONAVE ”UNITEC-STUDIO” shpk	PROÇEDURA E EKZAMINIMIT TË ELEKTRIÇISTËVE	Botimi: 01
		Nr. Doc : PT-EL-UTS-9.3.2
		Rishikimi: 00
		Data: 10/04/2020
Kopje Nr 1 nga 3 ne shperndarje te kontrolluar		Faqe 9 of 14
Adresa: Rruga »Gjergj Fishta » Nd. 2; H.39 ; Ap 8; Nj.A.V.10-1001 Tirane		

Të mos bëjë deklaratë mashtruese, mashtruese ose konfuzë lidhur me statusin e çertifikimit të personelit.

10. Pezullimi; tërheqja; reduktimi i fushës së veprimit të çertifikimit të personelit.

Bordi i Çertifikimit, ka miratuar procedurën, për t'i lejuar individëve të parashtrorëve ankesa lidhur me sjelljen e individëve që janë çertifikuar ose kandidat për çertifikimin e personit. Në rast se një individ shkel Kodin e Sjelljes, rregullat e çertifikimit të personit, ose politikën e programeve të çertifikimit të personit, Bordi i Çertifikimit, mund të qortojë, ose pezullojë individin ose mund të revokojë çertifikimin e personit.

Arsyet për sanksione sipas këtyre procedurave mund të përfshijnë, por jo domosdoshmërisht kufizohen në:

- shkelje të Kodit të Sjelljes;
- shkelja e politikave, rregullave dhe kërkesave të personelit të çertifikuar;
- dënimi penal ose çdo krim tjetër me pasoja morale; neglizhenca të mëdha;
- sjellja e keqe dhe e qëllimshme ose çdo sjellje tjetër jo etike në kryerjen e shërbimeve, përtë cilat individit është çertifikuar nga Trupa Çertifikuese UTS;
- mashtrim ose keqinterpretim në një aplikim fillestar të çertifikimit të personit, ose aplikim për ricertifikim.

Bordi i Çertifikimit duhet të përmbushë detyrat e mëposhtme lidhur me mohimin e ricertifikimit:

- a. Personat e çertifikuar dhe që u është mohuar çertifikimi, do të njoftohen me shkrim për revokimin e çertifikimit.
- b. Personave të çertifikuar dhe që u është mohuar çertifikimi, do t'u kërkohej që të kthejnë certifikatën e tyre dhe çdo dublikatë në Trupën Çertifikuese UTS.
- c. Personat e çertifikuar dhe që u është mohuar çertifikimi do të informohen për të drejtën e tyre për të apeluar vendimin.
- d. Apelimet e vendimit, për riformulim do t'i përcillen Komisionit të Ankesave dhe Disiplinës për shqyrtim.

UTS TRUPE PËR ÇERTIFIKIMIN E PERSONAVE ”UNITEC-STUDIO” shpk	PROÇEDURA E EKZAMINIMIT TË ELEKTRIÇISTËVE	Botimi: 01
		Nr. Doc : PT-EL-UTS-9.3.2
		Rishikimi: 00
		Data: 10/04/2020
Kopje Nr 1 nga 3 ne shperndarje te kontrolluar		Faqe 10 of 14
Adresa: Rruga »Gjergj Fishta » Nd. 2; H.39 ; Ap 8; Nj.A.V.10-1001 Tirane		

ANEKSI - A

Pyetjet e ekzaminimit me shkrimpër Skemen e Çertifikimit PT-EL-UTS-01

Teza e ekzaminimit përmban vetëm pyetje të zgjedhura në mënyrë të paparashikueshme nga trupa certifikuese mbi bazën e pyetjeve të dokumentuara si më poshtë:

Grupi 1.

1. Cfarë nënkupton me “Siguria dhe shëndeti në punë”?
2. Cilat janë disa nga kriteret që duhet të plotësojë kaska e mbrojtjes së kokës?
3. Cili është hapi i parë i cili merret pas konstatimit të një zjarri në ambientin e punës?
4. Cilat janë disa nga Pajisjet Mbrojtëse Individuale
5. Cilat janë hapat e aplikimit të nje fikse zjarri?
6. Njësia matëse e rrymes, tensionit, rezistences.
7. Si bëhet kontrolli i mungesës së tensionit?
8. Cfarë nënkuptojnë sinjalistikat e mëposhtme?



Grupi 2.

1. Cfarë është “Incident në punë”?
2. Cfarë është risku? Ku dallon nga rreziku?
3. Cilat janë disa nga kriteret e nevojshme të këpucëve të sigurisë?
4. Cilat janë disa nga udhëzimet që merni nga Drejtuesi Teknik përpara fillimit të punës?
5. Cfarë nënkuptohet me “Sigurimi i veglave të punës”?
6. Shkarkimet atmosferike dhe masat mbrojtëse.
7. Ceshte nulifikimi mbrojtës?
8. Cilat janë tiparet e sinjaleve të paralajmërimit?
9. Sa është distanca ndërmjet rrethimit dhe pjesëve përcjellëse të një impianti elektrik?

Grupi 3.

1. Përse është i nevojshëm mbajtja e jelekëve gjatë procesit të punës?
2. Cilat janë disa nga Lëndët shuarëse të zjarrit?

UTS TRUPE PËR ÇERTIFIKIMIN E PERSONAVE ”UNITEC-STUDIO” shpk	PROÇEDURA E EKZAMINIMIT TË ELEKTRICISTËVE	Botimi: 01
		Nr. Doc : PT-EL-UTS-9.3.2
		Rishikimi: 00
		Data: 10/04/2020
Kopje Nr 1 nga 3 ne shperndarje te kontrolluar		Faqe 11 of 14
Adresa: Rruga »Gjergj Fishta » Nd. 2; H.39 ; Ap 8; Nj.A.V.10-1001 Tirane		

3. Cili është ndryshimi midis sinjaleve të ndalimit dhe sinjaleve urdhëruese?
4. Cili është hapi i parë nëse vëreni se një koleg ka hasur kontakt me burime të hapura të energjisë elektrike?
5. Cfarë nënkupton në “Riskun ndaj zjarrit”?
6. Si behet heqja e tokzimit?
7. Si klasifikohen transformatorët e fuqisë?
8. Nëse në ambientin e punës është derdhur një lëndë e cila mund të jetë burim aksidenti cfarë masash duhet të merren?
9. Cilat janë rregullat e dhënies së ndihmës së parë në rastet e goditjeve elektrike?
10. Sa persona kërkohen minimalisht për rregullimin e një problemi të hasur në një impiant elektrik?
11. Cfare quajme tokezim pune
12. Cfare quajme nulifikim te mbrojtjes
13. Si behet mbrojtja e transformatoreve te rrymes dhe tensionit
14. Cfare duhet te siguroje skema, mbrojtja rele, automatika dhe regjimi i sistemit energjitik
15. Cilat jane provat qe kryhen per kontrollin e mbrojtjes gjate remontit te instalimeve dhe pajisjeve elektrike
- 16 Cili eshte parimi i tarimit i rregullatorit automatik te tensionit
- 17 Sa eshte minimumi i lejuar i vleres se rezistences te izolimit te kushinetave, te gjeneratoreve, kompensatoreve sinkron dhe te ngacmuesit bashke me tubacionet e montuara te vajit. Me cilin aparat kryhet matja.
- 18 Sa duhet te jete rezistenca e izolimit te qarkut te ngacmimit te gjeneratoreve dhe kompesatoreve sinkron qe ndodhen ne shfrytezim. Me cilin aparat matet kjo rezistence?
19. Ku tokezohet kazani i transformatorit?
20. Sa eshte luhatja maksimale e tensionit qe lejohet ne peshtjellen primare te transformatorit?
21. Me se mbrohen nga mbitensionete shkaktuara nga kushtet atmosferike impiantet e hapura 20-20kV?
22. Si mbrohet hyrja e nje linje 20-35kV?

Grupi 4.

1. Cili është hapi i parë që bën në fillim të orarit të punës?
2. Nëse një koleg është aksidentuar gjatë punës cili është hapi i parë që ju ndërmerni?
3. Cili është hapi i parë që merni kur gjatë procesit të punës ndodh një tërmet?
4. Cilat janë hapat e dhënies së ndihmës së parë?

UTS TRUPE PËR ÇERTIFIKIMIN E PERSONAVE ”UNITEC-STUDIO” shpk	PROÇEDURA E EKZAMINIMIT TË ELEKTRICISTËVE	Botimi: 01
		Nr. Doc : PT-EL-UTS-9.3.2
		Rishikimi: 00
		Data: 10/04/2020
Kopje Nr 1 nga 3 ne shperndarje te kontrolluar		Faqe 12 of 14
Adresa: Rruga »Gjergj Fishta » Nd. 2; H.39 ; Ap 8; Nj.A.V.10-1001 Tirane		

5. Cilat janë hapat e clirimit nga rryma elektrike të kolegut i cili ka rënë në kontakt me tensionin e ulët?
6. Cilat janë disa nga kriteret instalimeve të brëndshme?
7. Renditja e vendosjes dhe e heqjes se tokezimit.
8. Cilët janë masat e sigurimit teknik gjat kontrollit dhe provave të transmiseve elektrike?
9. Cilat janë aparatët matës elektrik ?
10. Në sa kategori ndahen punimet pa bërje tokëzimi?
11. Sa duhet te jete rezistenca e izolimit te qarkut te ngacmimit te gjeneratoreve dhe kompesatoreve sinkron qe ndodhen ne shfrytezim. Me cilin aparat matet kjo rezistence?
12. Cili eshte parimi tarimit i rregullatorit automatik te tensionit
13. Sa eshte minimumi i lejuar i vleres se rezistences te izolimit te kushinetave, te gjeneratoreve, kompensatoreve sinkron dhe te ngacmuesit bashke me tubacionet e montuara te vajit. Me cilin aparat kryhet matja.
14. Gjate remontit te pergjithshem te gjeneratoreve dhe kompesatoreve sinkrone rendisni matjet dhe provat kryesore qe kryhen.
15. Si behet pozicionimi i sakte ne vend i transformatoreve me rele gazore dhe ne cfare kendi pjerresie?
16. Ne nje Transformator ne te thate me konfigurim yll-yll, sa eshte niveli maksimal i lejuar i rrymes qe mund te rrjedhi ne neuter?
17. Nga pikepamja e mbrojtjes, cilat jane provat qe kryhen mbi nje transformator pas remontit ose venies ne pune per here te pare?
18. Kur eshte i nevojshem vendosja e shkarkueseve ne neutral per transformatoret dhe autotransformatoret?
19. Cilat matje kryhen kur testohen shkarkuesit ventil?
20. Si behet mbrojtja rele e nje elektromotori nga mbingarkesa?
21. Si realizohet mbrojtja e nje elektromotori nga lidhjet e shkurtra?
22. Cfare perfshin salla e komandes ne nje impiant elektrik?
23. Ne sistemin, rrjetat dhe pajisjet elektrike, listoni automatikat elektrike qe duhet te perdoren
24. Per qarqet sekondare te mbrojtjes, rele automatikes elektrike e sinjalizimit te matjes, telemekanikes dhe komandimit sa duhet te jete seksioni i percjellesit (baker) per qarqet e rrymes dhe te tensionit?
25. Sa eshte minimumi i lejuar i rezistences se izolimit per qarqet sekondare dhe mbrojtjes rele?
26. Ne nje transformator tensioni qe sherben per matje me 1 peshtjelle ne primar dhe 2 ne sekondar perkatesisht me vlera $35kV//100/\sqrt{3}/100/3$, ne cilen nga peshtjellat sekondare duhet te kryhet tokezimi?

UTS TRUPE PËR ÇERTIFIKIMIN E PERSONAVE ”UNITEC-STUDIO” shpk	PROÇEDURA E EKZAMINIMIT TË ELEKTRICISTËVE	Botimi: 01
		Nr. Doc : PT-EL-UTS-9.3.2
		Rishikimi: 00
		Data: 10/04/2020
Kopje Nr 1 nga 3 ne shperndarje te kontrolluar		Faqe 13 of 14
Adresa: Rruga »Gjergj Fishta » Nd. 2; H.39 ; Ap 8; Nj.A.V.10-1001 Tirane		

Grupi 5.

1. Cilat janë hapat të cilat ndërmerren gjatë ndërrimit të turnit dhe dorëzimit të ambientit të punës kolegut të turnit pasardhës?
2. Cilat janë dëmet shëndetësore që vijnë si pasoje e mos përdorimit të mjeteve mbrojtëse?
3. Cili është hapi i pare që ndërmerni nëse vëreni se ambienti i punës është duke u mbushur me tym të dendur si pasojë e një difekti të panjohur.
4. Nëse gjatë një aksidenti 2 kolegë janë dëmtuar nga ku njëri prej tyre ka dëmtim dhe gjakderdhje të lartë në pjesën e krahut ndërsa tjetri është në gjendje të fikët dhe nuk është i vetëdijshëm cili ka prioritet për ndihmën e parë?
5. Cilat janë hapat e clirimit nga rryma elektrike të kolegut i cili ka rënë në kontakt me tensionin e lartë?
6. Si klasifikohen transformatorët e fuqisë?
7. Shërbimi operativ?
8. Punime pa heqjen e tensionit.
9. Cfarë nënkuptohet me termin “Sëmundje profesionale”?
11. Sa duhet te jete rezistenca e izolimit te qarkut te ngacmimit te gjeneratoreve dhe kompesatoreve sinkron qe ndodhen ne shfrytezim. Me cilin aparat matet kjo rezistence?
12. Cili eshte parimi tarimit i rregullatorit automatik te tensionit
13. Sa eshte minimumi i lejuar i vleres se rezistences te izolimit te kushinetave, te gjeneratoreve, kompesatoreve sinkron dhe te ngacmuesit bashke me tubacionet e montuara te vajit. Me cilin aparat kryhet matja.
14. Gjate remontit te pergjithshem te gjeneratoreve dhe kompesatoreve sinkrone rendisni matjet dhe provat kryesore qe kryhen.
15. Si behet pozicionimi i sakte ne vend i transformatoreve me rele gazore dhe ne cfare kendi pjerresie?
16. Ne nje Transformator ne te thate me konfigurim yll-yll, sa eshte niveli maksimal i lejuar i rrymes qe mund te rrjedhi ne neuter?
17. Nga pikepamja e mbrojtjes, cilat jane provat qe kryhen mbi nje transformator pas remontit ose venies ne pune per here te pare?
18. Kur eshte i nevojshem vendosja e shkarkueseve ne neutral per transformatoret dhe autotransformatoret?
19. Cilat matje kryhen kur testohen shkarkuesit ventil?
20. Si behet mbrojtja rele e nje elektromotori nga mbingarkesa?
21. Si realizohet mbrojtja e nje elektromotori nga lidhjet e shkurtra?
22. Cfare perfshin salla e komandes ne nje impiant elektrik?
23. Ne sistemin, rrjetat dhe pajisjet elektrike, listoni automatikat elektrike qe duhet te perdoren

UTS TRUPE PËR ÇERTIFIKIMIN E PERSONAVE ”UNITEC-STUDIO” shpk	PROÇEDURA E EKZAMINIMIT TË ELEKTRIÇISTËVE	Botimi: 01
		Nr. Doc : PT-EL-UTS-9.3.2
		Rishikimi: 00
		Data: 10/04/2020
Kopje Nr 1 nga 3 ne shperndarje te kontrolluar		Faqe 14 of 14
Adresa: Rruga »Gjergj Fishta » Nd. 2; H.39 ; Ap 8; Nj.A.V.10-1001 Tirane		

24. Per qarqet sekondare te mbrojtjes, rele automatikes elektrike e sinjalizimit te matjes, telemekanikes dhe komandimit sa duhet te jete seksioni i percjellesit (baker) per qarqet e rrymes dhe te tensionit?

25. Sa eshte minimumi i lejuar i rezistences se izolimit per qarqet sekondare dhe mbrojtjes rele?

26. Ne nje transformator tensioni qe sherben per matje me 1 peshtjelle ne primar dhe 2 ne sekondar perkatesisht me vlera $35kV//100/\sqrt{3}/100/3$, ne cilen nga peshtjellat sekondare duhet te kryhet tokezimi?

ANEKSI - B

Pyetjet e Ekzaminimit Praktik

1. Lidhja e një qarku të thjesht elektrik
2. Realizimi i matjes së tensionit
3. Lidhja e automatit
4. Montimi i çelsave devijat dhe invertitor.

Ekzaminimi praktik i kandidatit, përmban zbatimin e detyrave specifike të kandidatëve, që shërbejnë sielektriciste ne shfrytezimin e pajisjeve dhe instalimeve elektrike. Ekzaminimi i çdo kandidati ose mbajtësi të certifikimit, që i nënshtrohet ekzaminimit praktik, identifikohet në mënyrë unike dhe mbahet raport që përmban kontrollin për gjëndjen dhe funksionimin e sigurtë të pajisjeve dhe instalimeve elektrike, veprimet për vënien në punë shfrytëzimin, heqjen nga puna, mirëmbajtjen, veprimin në rast avarie të pajisjeve dhe instalimeve elektrike.

Raporti përpilohet mbështetur në dëshmimin në vend të kandidatit/ mbajtësit të certifikimit, dhe bëhet i vlefshëm nga firma e ekzaminuesit që ka dëshmuar mbikqyrjen e kandidatit/ mbajtësit të certifikatës në veprimtaritë e shfrytëzimit të pajisjeve dhe instalimeve elektrike përkatëse.

Koha mesatare e lejuar përcaktohet për seicilin rast nga trupa certifikuese. Koha e lejuar për provimin varet nga numri i pajisjeve dhe instalimeve elektrike për të cilat provohet kandidati dhe nga kompleksiteti i tyre.

Të gjithë kandidatët për certifikimin si elektrikiste, duhet të kenë plotësuar me sukses (me një shkallë prej $\geq 70\%$), provimin praktik në sektorin dhe metodën përkatëse.